



VENDIM

Nr. 47 Datë 24.05.2011

**PËR
PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2011
PËR TË LICENSUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 12, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.05.2011, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2011 për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit sipas nivelit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2010, nga secili operator i licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrik,

Vendosi:

1. Përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2011 për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.